



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS  
DHOMAT E SHKALLËS SË DYTË

---

Numri i lëndës: 2020:167865  
Datë: 25.04.2024  
Numri i dokumentit: 05619629

K.DH.SH.II.nr.1612/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhomat e Shkallës së Dytë, gjyqtari Dren Rogova, ne çështjen juridike përmbarimore të kreditorit “Omnihem Farm” .D.O.O.E.L , me seli ne Shkup Maqedoni te cilën sipas autorizimit e përfaqëson avokat A.K. me seli ne Prishtinë, kundër debitorit “ORFOKOSOVA” shpk, me seli ne Prishtinë qe sipas autorizimit e përfaqëson avokat V.B., me seli ne Prishtinë, me bazë juridike përmbarimore, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorit, e paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale te Kosovës-Dhomat e Shkallës se Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike KPPP.nr.601/2022 dt.19.09.2023, me datën 25.04.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET e pabazuar ankesa e debitorit “ORFOKOSOVA” shpk, me seli ne Prishtinë, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale te Kosovës-Dhomat e Shkallës se Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike KPPP.nr. 601/2022 dt.19.09.2023, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale te Kosovës-Dhomat e Shkallës se Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktvendimin e ankimuar KPPP.nr. 601/2022 dt.19.09.2023, ne pjesën e parë te dispozitivit te aktvendimit ka aprovuar pjesërisht prapësimin e debitorit “ORFOKOSOVA” shpk, me seli ne Prishtinë dhe ka anuluar urdhrin përmbarimor P.nr.258/20 dt.18.08.2020, i lejuar nga Përmbaruesi Privat Bardh B. Tasholli, për shumën e detyrimit prej 1,744.00 euro dhe ka përfunduar procedurën ne këtë pjesë te përmbarimit. Ne pjesën e dytë te dispozitivit te aktvendimit ka refuzuar pjesërisht prapësimin e debitorit “ORFOKOSOVA” shpk, me seli ne Prishtinë dhe ka lënë ne fuqi pjesën tjetër te urdhrit përmbarimor P.nr.258/20d dt.18.08.2020 për borxhin prej 2,666.00 euro, ndërsa sa i përket shpenzimeve për përfaqësim ne seancën dëgjimore gjykata ka vendosur ti bartë secila palë veç e veç.

Kundër këtij aktvendimi, në afatin ligjor ka paraqitur ankesë debitori, për shkak te vërtetimit te gabuar dhe jo te plote te gjendjes faktike, me propozim qe gjykata e shkalles se dytë ta aprovoj Dhoma e Shkalles se Dytë e Gjykatës Komerciale, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të dispozitës së nenit 208 të

Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) e lidhur me nenin 17 të Ligjit për Procedurën Përmbartimore (LPP), gjeti se:

- Ankesa e debitorit është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori “Omnihem Farm” .D.O.O.E.L , me seli ne Shkup Maqedoni, më datën 18.08.2020, ka paraqitur propozim për përmbartim ndaj debitorit “ORFOKOSOVA” shpk, me seli ne Prishtinë, në bazë të dokumentit të besueshëm-Faturës me nr.171/2017 dt.25.08.2017. Përmbartuesi Privat Bardh B. Tasholli –Ferizaj, sipas propozimit te kreditorit, me urdhrin përmbartimor P.nr.258/20 dt.18.08.32020, ka lejuar përmbartimin, me të cilën detyrohet debitori që kreditorit në emër te borxhit nga fatura t’i paguaj shumën prej 4,410.00 euro, me kamatë prej 8% ne vit nga data kur kërkesa është bere e arritshme e deri ne pagesën definitive si edhe shpenzimet e procedurës.

Kundër urdhrin përmbartimor debitori ka paraqitur prapësim me datë 05.10.2020 duke deklaruar se e fatura e cila është ne proces te përmbartimit e lëshuar nga kreditorit është e paguar siç evidentohet ne fletëpagesën ku shihet se debitori ka përfunduar obligimet ndaj kreditorit ne shumen totale prej 3,200.00 euro. Obligimet janë përfunduar ne mënyrë vullnetare përveç një fature ne vlerë prej 1000 euro për te cilën kreditori dhe debitori janë dakorduar se kreditori ne cilësi te furnizuesit te debitorit te ofroj një ekspert për te vlerësuar cilësinë e mallit ndërsa nga ana e kreditorit nuk është ndërmarr asnjë veprim, propozon qe gjykata ta pranoj prapësimin e debitorit, ta shfuqizoj urdhrin përmbartimor, ta refuzoj urdhrin përmbartimor dhe ta obligoj kreditorin te përmbush te gjitha shpenzimet e procedurës.

Përgjigje ndaj prapësimit te debitorit ka ushtruar kreditori, duke precizuar borxhin e debitorit ne shumen prej 2,953.00 euro dhe thekson se konstatimi i debitori se gjoja për shkak te cilësisë se mallit 1,000.00 euro nuk janë paguar nuk qëndron, sepse fillimisht obligimi i debitorit ne lartësi prej 2,953.00 euro dhe se dyti me asnjë provë nuk prezanton për një gjë te tillë. Propozon qe gjykata ta refuzoj prapësimin e debitorit ne tërësi, ta obligoj te njëjtin ti paguaj shumen prej 2,953.00 euro te precizuar nga vet kreditori dhe ta obligoj debitorin te paguaj shpenzimet për përpilim te kësaj përgjigje sipas tarifës se OAK.

Gjykata Komercale e Kosovës-Dhomat e Shkalles se Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike, pas vlerësimit të prapësimit dhe përgjigjes në prapësim, ka nxjerrë aktvendimin KPPP.nr.601/22 dt.19.09.2023 me të cilin e ka vendosur decidivisht si në dispozitiv të aktvendimit të atakuar. Ka arsyetuar. Gjykata nga shkresat ne lëndë ka gjetur se debitori ka bërë dy pagesa tek kreditori dhe atë me datën 18.03.2019 ne vlerën prej 2,000.00 euro dhe me datën 08.07.2019 ne vlerën prej 1,200.00 euro, me mbishkrimin pagësë e pjesërishme. Nga kartela e kreditorit rezulton se nga pagesa e datës 18.03.2019 ne vlerën prej 2,000.00 euro, fatura e cila është objekt i këtij përmbartimi është zbritur ne vlerën prej 544 euro, ndërsa pagesa e dytë prej 1,200.00 euro është marrë si tërësi si pagesë e faturës qe është objekt i këtij përmbartimi. Pagesat e ofruara nga debitori ne vlerën prej 3,200.00 euro nuk i referohen shprehimisht faturës qe është

objekt i këtij përbarimi ndërsa kreditori përmes kartelës se tij pohon se nga kjo pagesë është zbritur fatura objekt i këtij përbarimi fillimisht ne vlerën prej 544 euro dhe me pastaj edhe ne vlerë prej 1,200.00 euro, e ne total si pagesë për faturën nr.171/2017 është llogaritur shuma prej 1,744.00 euro dhe se borxhi i papaguar nga e gjithë kjo rezulton te jetë ne shumen rrejt 2,666.00 euro. Gjykata bazuar ne nenin 71. par.1 nenpar.1.2 te LPP vendos si ne piken e parë te dispozitivit te aktvendimit dhe ka përfunduar procedurën për këtë pjesë te përbarimit konform nenit 66.4 te LPP.

Gjykata ka vendos si ne piken e dytë te dispozitivit te aktvendimit dhe ka lënë ne fuqi urdhrin përbarimor sa i përket borxhit ne shumen prej 2,666.00 euro pasi lidhur me këtë borxh qe rrjedh nga fatura 171/2017, debitori ka dështuar te ofroj prova se e njëjta është përmbushur apo se eksitojnë bazat ligjore për shfuqizimin e urdhrin përbarimor për këtë pjesë, te parapara me nenin 71 te LPP. Gjykata i ka analizuar edhe pretendimet e debitorit por te njëjtat i vlerësoji si te paqëndrueshme sepse ne përshkrimin e pagesave te lartcekura, këto pagesa nuk i referohen askund faturës qe është objekt i këtij përbarimi por mbajnë vetëm përshkrimin pagesë e pjesërishme, ndërsa ne lidhje me shpenzimet ka vendosur konform nenit 463 par.1 te LPK.

Nisur nga kjo gjendje e çështjes, Gjykata Komerciale – Dhoma e shkalles se dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë i ka zbatuar drejtë dispozitat e Ligjit të Procedurës Përbarimore me rastin e vendosjes, ngase edhe sipas vlerësimit të kësaj gjykate me shikim në shkresat e lëndës qartë konstatohet se përbarimi është lejuar në bazë të faturës nr.171/2017 dt.25.08.2017 te lëshuar nga kreditori. Edhe për ketë gjykate gjendja faktike konsiston me atë te konstatuar nga gjykata e shkallës e parë sepse nga shkresat e lendes rezulton edhe për këtë gjykate se debitori ka bërë dy pagesa tek kreditori dhe atë me datën 18.03.2019 ne vlerën prej 2,000.00 euro dhe me datën 08.07.2019 ne vlerën prej 1,200.00 euro, me mbishkrimin pagësë e pjesërishme. Po ashtu sipas kartelës se kreditorit ne raport me pagesat e bëra qe gjenden ne lende rezulton se nga pagesa e datës 18.03.2019 ne vlerën prej 2,000.00 euro, fatura nr.171/2017 dt.25.08.2017 është zbritur ne vlerën prej 544 euro, ndërsa pagesa e dytë prej 1,200.00 euro është marrë si tërësi si pagesë e faturës nr.171/2017 dt.25.08.2017. Ndërsa fakti se nga pagesat e ofruara nga debitori ne total me vlerën prej 3,200.00 euro, nuk është e precizuar shprehimisht fatura qe është objekt i këtij përbarimi, por fakti tjetër se kreditori përmes kartelës se tij pohon se nga kjo pagesë është zbritur fatura objekt i këtij përbarimi fillimisht ne vlerën prej 544 euro dhe me pastaj edhe ne vlerë prej 1,200.00 euro, pra ne total ne shumen 1,744.00 euro, rezulton se borxhi i papaguar nga debitori ndaj kreditorit del te jetë ne shumen prej 2,666.00 euro.

Prandaj, bazuar ne këto arsye, Gjykata e shkallës se dytë vlerëson se gjykata e shkallës së parë në bazë të provave të cilat i ka pasur në dispozicion në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendimin e saj te bazuar në dispozita ligjore, ashtu qe përfundimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon edhe Gjykata e shkallës se dytë, duke vlerësuar po ashtu se aktvendimi i atakuar është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika (b), (g), (j) (k) dhe (m) të LPK dhe ne konstatim te gabuar dhe jo te plotë te gjendjes faktike e të

cilat shkaqe ankimore gjykata e shkallës së dytë i vlerëson edhe sipas detyrës zyrtare, në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Edhe Gjykata e shkallës së dytë analizoi pretendimet e debitorit se transaksionet bankare janë përfunduar për borxhin sipas faturës nr.171/2017 dhe pretendime tjera por i vlerësoj si të paargumentuara sepse nga shkresat e lëndës nuk rezulton se është kryer pagesa si në pjesën e dytë të dispozitivit të aktvendimit të gjykatës së shkallës së parë e të cilën konform shkresave në lende e konstaton edhe kjo gjykatë, ashtu që këto pretendime i refuzoi si të pabazuara ndërsa aktvendimin e shkallës e parë e vërtetoi.

Kompetenca e Dhomës së Shkallës së Dytë për të vendosur nga ana e gjyqtarit individual bazohet në dispozitën e nenit 3 paragrafi 2 të LPP-së, me të cilën është paraparë se në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 209 paragrafi 1 pika (b) të LPK lidhur me nenin 17 të LPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS,  
Dhomat e Shkallës së Dytë  
K.DH.SH.II nr.1612/23, me datë 25.04.2024

Gjyqtari,  
Dren Rogova